



Lëvizja në rrugë në Gjermani –
çfarë duhet të kem parasysh?
Rregullat kryesore të qarkullimit rrugor

SHQIP



Mirëseerdhët në Gjermani

Ju lëvizni në rrugët tona çdo ditë, si këmbësorë, çiklistë, pasagjerë në autobusë apo tramvaje e ndoshta edhe me motoçikleta apo makina. Për mbrojtjen tuaj dhe për arsye sigurie në përgjithësi, ekzistojnë rregulla të shumta të trafikut në Gjermani. Disa prej tyre janë të njohura për ju, ndërsa të tjera janë ndoshta tërësisht të reja.

Rregulli më i rëndësishëm nga të gjithë: **Të tregoni kujdes dhe të mos rrezikoni as veten as të tjerët.**

Përmbajtja


Ju ecni në këmbë	6-11
Ju lëvizni me biçikletë, biçikletë kargo, skuter elektrik	12-19
Ju lëvizni me biçikleta motorike, motoçikleta, motorë	20-21
Ju lëvizni me makinë	22-27



TË LËVIZËSH NË KËMBË



LËVIZJA ME BIÇIKLETË & SKUTER ELEKTRIK



ME BIÇIKLETË TË MOTORIZUAR, MOTORÇIKLETË DHE MOTOR



LËVIZJA ME MAKINË

FAQET 6-11

- Trotuarët
- Ana e rrugës
- Të shikosh dhe të shikohesh nga të tjerët
- Pedonalet
- Zonat me qarkullim të lehtësuar
- Korsi e përbashkët për këmbësorë dhe biçikleta
- Kalimi i rrugës
- Stacionet e autobusit

FAQET 12-19

- Biçikleta e sigurt
- Mbjajtja e distancës
- Marrja e kthesës
- Korsi të biçikletave & pedonalet
- Mbjajtja e kaskës në biçikletë!
- Biçikleta kargo
- Skuteri elektrik

FAQET 20-21

- Kur mund të lëviz me biçikletë të motorizuar, motoçikletë, motor?
- Detyrimi për mbajtjen e kaskës
- Korsia e ndarë për biçikleta dhe biçikletat e motorizuara
- Lëvizja me motor

FAQET 22-27

- Në cilën moshë mund ta ngas makinën?
- Detyrimi i vënies së rripit
- Ndenjëset e fëmijëve
- Moti dhe mënyra e drejtimit të automjetit
- Shërbimi i urgjencës 112
- E kuqe = Stop
- Hyrja në një vend
- Rruga kombëtare dhe autostrada



Ju ecni në këmbë



NË QYTETE ka trotuarë për personat që ecin në këmbë. Përdorni gjithmonë këto trotuarë. Rrugët për automjetet dhe çiklistët janë këtu.

Nëse trotuarët nuk janë të pranishëm, shkoni në anë të rrugës.



JASHTË ZONAVE TË NDËRTUARA

Këtu lejohet të ecni vetëm përgjatë anës së majtë të rrugës, sepse në këtë mënyrë mund të shihni më mirë trafikun që vjen, dhe nëse është e nevojshme, mund të reagoni duke u larguar mënjane.

Ecni në një grup njëri pas tjetrit.





Ngandonjëherë ka vetëm rrugë të tëra ose lagje që janë vetëm për këmbësorë: **Këto quhen PEDONALE.**

Në zonat ME TRAFIK TË RELAKSUAR

këmbësorëve u lejohet që ta përdorin të gjithë rrugën, drejtuesit e automjeteve dhe të biçikletave duhet të tregojnë shumë kujdes për këmbësorët.

Fëmijët lejohen të luajnë në rrugë dhe të ngasin automjete të ndryshme për fëmijë (si p.sh. triçikleta, patina, biçikleta, etj.) Drejtuesit e automjeteve duhet ta kenë parasysh këtë dhe të lëvizin me ritmin e ecjes.

Por përdoruesit e rrugës nuk duhet ta pengojnë njëri-tjetrin. Megjithatë, nuk ka asnjë privilegj për këmbësorët.



Kur errësohet ose natën, **duhen mbajtur** veshje në ngjyrë të çelët ose reflektuese.



Në disa trotuarë ose ndonjëherë edhe në pedonale u lejohet edhe çiklistëve që të kalojnë. Por gjithësesi, aty duhet të jetë një tabelë. Në këtë rast ka shumë rëndësi respektimi reciprok.

KORSIA E PËRBASHKËT PËR KËMBËSORËT DHE ÇIKLISTËT

Kur doni të kaloni rrugën, duhet ta bëni këtë në rrugë të drejtpërdrejtë dhe menjëherë. Sidomos duhet të bëni kujdes për automjetet dhe çiklistët. Mundësisht mos kaloni midis mjeteve që parkojnë.

Është mirë të përdorni vende ku është e sigurt për të kaluar, edhe nëse është një devijim i vogël për të arritur atje.



SEMAFORËT

Për këmbësorët ka semaforë më vete. Në të shumtën e rasteve në kryqëzime, por ngandonjëherë edhe midis. Me dritë të kuqe duhet të qëndroni gjithmonë në vend. Me dritën jeshile mund të ecni. Megjithatë jini të vëmendshëm për të parë, nëse drejtuesi i makinës apo biçikletës ndalon.





Në semaforë **TË DEDIKUAR PËR KËMBËSORËT**

shpesh ka **butona të verdhë**, të cilat mund të shtypen që semafori të japë dritën jeshile. Prisni sa të dalë jeshilja.



VIJAT E BARDHA

Edhe këtu ju mund ta kaloni rrugën në mënyrë të sigurt. Automjetet duhet të ndalojnë. Por megjithatë kini kujdes, bëjeni të qartë se doni të kaloni rrugën **prisni derisa automjetet të ndalojnë** dhe kaloni rrugën me shpejtësi.

ISHULLI QENDROR

Këtu automjetet nuk duhet të ndalojnë domosdoshmërisht. Prandaj, shikoni me kujdes nëse rruga është e lirë dhe ecni me shpejtësi deri në ishull. **Aty mund të prisni**, në qoftë se nga drejtimi i kundërt ka trafik.





KUJDES KUR KALONI RRUGËT ME TRAMVAJE

Këto kanë gjithmonë përparësi, sepse nuk mund të frenojnë aq shpejt.

Kur jeni duke ecur në rrugë me fëmijë të vegjël, **kapini gjithmonë përdore**, në mënyrë që të mos hidhen në rrugë.





Kur shikoni një automjet me dritë blu ose dëgjoni një sirenë të tillë (tatyтата), duhet të bëni shumë kujdes dhe në asnjë rast nuk duhet ta shkelni rrugën. Këto janë në të shumtën e rasteve makina të policisë, zjarrfikësit ose **një ambulancë në një rast urgjence.**

AUTOBUSËT në Gjermani nuk mund të ndalohen duke ia u bërë me dorë. Ata ndalojnë vetëm në stacionet e autobusit. Aty zakonisht do të gjeni të afishuar edhe planin e lëvizjeve me oraret e nisjes së autobusëve.

Mbajeni trafikun gjithmonë në fokus të vëmendjes dhe shmangni devijimet!





Ju lëvizni me biçikletë



Në parim, për drejtuesit e biçikletave janë në fuqi **të njëjtat rregulla të qarkullimit që zbatohen edhe për drejtuesit e automjeteve.**

(Rregullat e të drejtës së kalimit, rrugët me një drejtim, semaforët...)

Biçikleta e sigurt në rrugë

Një biçikletë duhet të ketë ndriçim frena dhe një zile.

Në biçikletë lejohet të jetë i hyhur vetëm një person.





Fëmijët e vegjël duhet të jenë të **siguruar** në ndenjese të veçanta ose rimorkio.

Kur jeni me biçikletë duhet të ecni sa më djathtas.

Mbani sa më shumë **distancë** me makinat që parkojnë, në mënyrë që të mos përplaseni me një derë që papritur është duke u hapur.



Përpiquni që të mos ecni me biçikletë shumë afër me njëri-tjetrin. Nëse jeni duke lëvizur së bashku me disa persona **lëvizni njëri pas tjetrit**.

Nëse doni të ktheheni majtas ose djathtas kur jeni me biçikletë, duhet ta tregoni këtë gjë me dorën e shtrirë. Përpara se të merrni kthesën, sigurohuni që rruga të jetë e lirë.

Rregulli: E djathta para të majtes

Nëse në rrugë nuk ka tabela që të lejojnë të kalosh, mund të kalojë i pari përdoruesi i rrugës që vjen nga e djathta përmes një kryqëzimi (djathtas para majtas). Në një kryqëzim të tillë djathtas-para-majtas, shoferët duhet të lënë çiklistët që vijnë nga e djathta të kalojnë të parët.



Gjithashtu, ka edhe rregulla të veçanta për drejtuesit e biçikletave, p.sh. **semaforët e çiklistëve** ose ekziston edhe mundësia që një rrugë me një drejtim të kalohet në drejtim të kundërt.

Tabelë shtesë “E lirë për çiklistët”

Nëse në një korsi biçikletash qëndron një tabelë me biçikletë të bardhë, kjo korsi duhet të përdoret, ajo është e detyrueshme për t'u përdorur. Pa shenja të tilla ju mund të lëvizni në rrugë, por mund të qëndroni edhe në korsinë e biçikletave.

Korsia e biçikletave

Në rast se një tabelë e tillë është e pranishme në korsinë e biçikletave, përdorimi i saj këtu është i rregull. Nga ana tjetër, nuk është e lejuar të lëvizet me makinë në rrugë.



Mos e ngisni biçikletën kur keni pirë alkool.

Mos flisni në telefon kur jeni duke ngarë biçikletën.

Ka rrugë, në të cilat ju **në asnjë mënyrë nuk duhet të ngisni biçikletën**, p.sh. autostradat ose rrugët automobilistike.

Gjithashtu, edhe trotuarët ose pedonaltet nëpërmjet tabelave mund të hapen për drejtuesit e biçikletave. Në këtë rast, ata nuk duhet të ecin më shpejt se sa këmbësorët dhe duhet t'i respektojnë ata.

Kujdes: Kur drejtuesi i një kamioni merr kthesën djathtas, mundet që ai të mos ju shohë. Prandaj, është më mirë që të qëndroni mbarpa kamionit dhe në rast nevojë të hiqni dorë nga e drejta e përparësisë.

Kur ngisni biçikletën mundësisht të mbani një kaskë. Kjo mund t'ju ruajë nga dëmtimet e rënda në kokë.





Fëmijët lejohet ta ngasin biçikletën në rrugë vetëm pasi kanë mbushur 8 vjeç, më herët vetëm në trotuar.

Zakonisht, fëmijët në Gjermani bëjnë një test çiklizmi kur janë në klasën e 4-t të shkollës fillore.

Kur situata në trafik është e pamëshueshme, ju mund edhe të zbrisni nga biçikleta dhe ta shtyni atë me dorë.

Atëhere duhet të silleni njësoj si një këmbësor.





BIÇIKLETAT KARGO

Në qytet mund të lëvizni edhe me një biçikletë kargo. Të gjitha ato rregulla, që vlejnjë për drejtuesit e biçikletave, zbatohen edhe për drejtuesit e një biçiklete kargo. Përpara se ta përdorni biçikletën kargo, duhet më parë të familjarizoheni me të. Bëni kujdes që të siguroni veçanërisht fëmijët dhe që të gjithë të mbajnë një kaskë.



KORSIA E SHPEJTË E BIÇIKLETAVE

Shigjeta jeshile për qarkullimin me biçikleta i lejon çiklistët të kthehen djathtas në korsitë mbrojtëse, korsitë e çiklizmit ose shtigjet e ndërtuara të çiklizmit gjatë një faze me të kuqe.



Ju lëvizni me skuterin elektrik

Skuterat elektrik janë të lejuar në **korsitë e biçikletave, vijat e çiklizmit dhe në rrugët e çiklizmit**. Vetëm nëse mungojnë, mund të kalohet në rrugë. Skuterat elektrik janë të ndaluar në trotuarë, në pedonale dhe në rrugët me një drejtim kundër drejtimit të lëvizjes.



Nëse hyrja është e ndaluar në rrugët me një drejtim, tabela shtesë "E lirë për çiklistët" vlen edhe për automjetet e vogla elektrike.

Përdorimi i mjeteve të vogla elektrike në sipërfaqet e tjera të qarkullimit mund të lejohet me ndihmën e tabelës shtesë "E lirë për çiklistët".

Drejtimesit e skuterave elektrik nuk kanë nevojë për çertifikatë testimi të motoçikletave ose patentë shoferi.




Mosha minimale për drejtimin e një skuteri elektrik (automjet i vogël elektrik) është 14 vjeç.

Nuk ka detyrim për mbajtjen e kaskës. **Gjithësesi, mbajtja e kaskës rekomandohet me insistim**, pasi kjo në çdo rast mund të pengojë nga dëmtimet në kokë. Për një skuter elektrik nevojitet një numër sigurimi. Edhe në rastin e skuterit elektrik lejohet të lëvizë vetëm një person.



Ju lëvizni me biçikletë motorike, motoçikletë, motor



Në Gjermani ka lloje të ndryshme biçikletash të motorizuara, për të cilat zbatohen rregulla të ndryshme. Megjithatë, këto gjëra vlejné për të gjithë:

Për përdorimin e tyre është gjithmonë detyrimi për mbajtjen e kaskës dhe detyrimi për t'u siguruar, si dhe një moshë minimale.

Si rregull, ju duhet gjithashtu edhe një leje drejtimi e posaçme ose një certifikatë testimi.

Nëse keni një patentë ndërkombëtare ose të huaj, ju lutemi pyesni nëse dhe për sa kohë ajo është e vlefshme në Gjermani dhe cilat motoçikleta ju lejohe të ngisni me të.





Në parim, të gjitha biçikletat e motorizuara lëvizin vetëm në rrugë. Vetëm biçikletat motorike, të cilat lëvizin me shpejtësi 25 km/h, lejohet – jashtë qyteteve dhe kur ekziston sinjalistika e posaçme - të lëvizin edhe në korsi të biçikletave.

Edhe këtu, rregulli për të lëvizur në krah të djathtë vlen për të gjithë përdoruesit e rrugës, përveç rastit të çiklistëve.

Biçikletat motorike, motoçikletat dhe motorët nuk lejohen të gjarpërojnë nëpër trafik.

Në motorë lejohet që të jenë të hipur maksimumi dy veta. Mos merrni me vete fëmijë në motor.

Mos e ngisni motorin kur keni pirë alkool.





Ju lëvizni me makinë



Kushdo që do të ngasë makinën në Gjermani, duhet të ketë **një leje drejtimi të vlefshme**. Nëse keni një leje drejtimi ndërkombëtare ose të huaj, informohuni ju lutem, nëse është e vlefshme në Gjermani dhe për sa kohë.

Një makinë duhet të jetë gjithmonë e siguruar.

Nëse e merrni një makinë hua nga miqtë tuaj, verifikoni nëse edhe ju si personi që ngjisi makinën jeni të mbrojtur nga sigurimi.

Të gjithë personat e tjerë që janë brenda në makinë duhet të jenë të lidhur me rripin e sigurimit, përfshi edhe ata në sediljen mbrapa.





Të gjithë fëmijët nën moshën 12 vjeç, që janë më të shkurtër se 150 cm, duhet që **të sigurohen** në ndenjësë të posaçme për fëmijët. Ekzistojnë modele të ndryshme në varësi të moshës.

Mos flisni në telefon duke pasur celularin në dorë, mos shkruani mesazhe dhe mos përdorni asnjë pajisje tjetër elektronike kur jeni duke ngarë makinën.

Mos e ngisni makinën kur keni pirë alkool.

Për lloje të ndryshme rrugësh ka shpejtësi të ndryshme maksimale, me të cilat ju lejohet të udhëtoni.

Respektoni sinjalistikën në anën e djathtë të rrugës ku jeni duke lëvizur. Në varësi të gjendjes së rrugës apo të motit, edhe makinës duhet t'i jepni më me kujdes dhe më ngadalë. **Lu-temi përshtateni shpejtësinë sipas kushteve.**





Nëse jeni përfshirë në një aksident, merrni në telefon urgjencën me numrin 112.

Në çdo rast duhet të qëndroni në vendin e aksidentit, derisa të vijë policia.



E kuqja do të thotë Stop! Prandaj, asnjëherë mos kaloni me të kuqe ose të kaloni një tabelë të kuqe që tregon Stop (Fig.) Për këtë zakonisht vendosen gjoba, deri në ndalim të përkohshëm të drejtimit të automjetit.



NDALIM PARAKALIMI I AUTOM-JETEVË ME NJË KORSI

Në qoftë se ekziston një tabelë e tillë, nuk duhet t'i parakaloni me makinë automjetet me një kors. Një distancë prej 1,5 metrash vlen për parakalimin e çiklistëve në zonat e banuara dhe 2 metra jashtë zonave të banuara.

NË QYTET

Kujdes shumë i madh kërkohet sidomos në qytet. Këtu ekzistojnë si për këmbësorët dhe drejtuesit e biçikletave, ashtu edhe për autobusët, kamionët dhe tramvajet, shumë kryqëzime dhe semaforë.





Fillimi dhe fundi i një qyteti apo lokaliteti në Gjermani janë të shenjuara me tabela.

Në zonat e banuara, shpejtësia maksimale është zakonisht 50 km/h.

NËZONAT E BANUARA DHE PËRPARA SHKOLLAVE shpesh kërkohet të respektohet një shpejtësi maksimale sa më e ulët prej 30 km/h. Dhe shpesh kjo vlen për të gjitha zonat. Përndryshe, mund të zbatohen pothuajse të gjitha limitet e shpejtësisë në qytete: 10 km/h, 20 km/h, 30 km/h, 40 km/h ...

Pra, respektoni gjithmonë me përpikmëri tabelat e qarkullimit. Ato ndodhen në anë të rrugës në krahë të djathtë.



Jini jashtëzakonisht të kujdesshëm kur ktheheni majtas dhe djathtas, veçanërisht nëse ktheheni në pika qorre: lëri-ni këmbësorët dhe çiklistët të kalojnë drejt të parët, ata kanë përparësi.

Edhe brenda zonave të ndërtuara, ju dhe të gjithë pasagjerët duhet të jeni të lidhur në makinë, me rrypin e siguries.



NË RRUGËT KOMBËTARE

Jashtë zonave të banuara, në rrugët e vendit nuk duhet të udhëtohet me një shpejtësi më të lartë se 100 km/h, madje shpesh duhet të jetë edhe më e ulët se kaq. Një gjë e tillë tregohet edhe me tabelat përkatëse.

Bëni kujdes kur parakaloni në rrugët e vendit: Shpesh pamja nuk është e mjaftueshme. Kështu që ngiteni makinën në mënyrë më të përmbytur.



Kur shikoni një **tabelë ku ndalohet parakalimi**, në asnjë mënyrë nuk duhet që të parakaloni. Gjithashtu, edhe një vijë e drejtë nuk lejohet që të shkelet.

Kur ktheheni majtas, respektoni makinat që vijnë nga krahu i kundërt!





NË AUTOSTRADË

Zakonisht ka të paktën dy korsi në secilin drejtim. Shpejtësia maksimale e rekomanduar është 130 km/h.

Shpesh ka edhe limite të tjera, që janë të treguara me tabela. Respektojini ato gjithmonë. Në rast dyshimi, ka gjoba të larta si dhe ndalime të drejtimet të makinës.

Edhe në autostrada duhet ta ngjisni makinën djathtas (rregulli i lëvizjes në krah të djathtë) Për të parakaluar, makinave që janë duke lëvizur më ngadalë duhet t'i kaloni afër nga krahu i majtë. Parakalimi në krah të djathtë është i ndaluar, po kështu edhe kthimi mbrapa ose rrotullimet me makinë.

Vetëm në rast urgjence ose avarie ju lejohet të ndaloni në korsinë e avarive të autostradës.

Në qoftë se kur jeni në autostradë ndodheni në një situatë emergjente dhe nuk keni mundësi të telefononi, në distanca të caktuara do të gjeni të ashtuquajturat **kolonat e thirrjeve emergjente**, prej ku ju mund të kërkonit ndihmë.



Në situata emergjente ose avarie lutemi të përdorni gjithmonë jelekët paralajmërues. Këto duhet t'i keni në dispozicion në automjetin tuaj. Në raste të tjera, mbajtja e tyre është e ndaluar.

Për pushim kërkonit një shesh pushimi. Dilni nga autostrada vetëm në hyrjet dhe daljet ekzistuese.

Asnjëherë mos ecni në këmbë në autostradë!





Informacione të tjera:



www.germanroadsafety.de

Në këtë faqe interneti mund ta shkarkoni broshurën falas edhe në versionet e gjuhëve të tjera.



Publikuar nga:

Deutscher Verkehrssicherheitsrat (DVR)
Jägerstr. 67-69
10117 Berlin
www.dvr.de

Deutsche Verkehrswacht e.V.
Budapester Straße 31
10787 Berlin
www.deutsche-verkehrswacht.de

Unfallforschung der Versicherer (UDV)
Wilhelmstraße 43/43 G
10117 Berlin
www.udv.de, www.gdv.de

Redaksia:

Olivera Scheibner (DVR), Kay Schulte (DVR),
Daniel Schüle (DWW), Jörg Ortlepp (UDV)

Koncepti, faqosja, tekstet

P.AD. Werbeagentur, Meinerzhagen
2022

Evidenca fotografike:

www.dvr.de
www.shutterstock.de